



**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN PËRFUNDIMTAR
NË PROFILIN MËSIMOR “ELEKTRONIKË NË TEKNOLOGJINË E
AUTOMATIZIMIT (pilot - PEM)”, NIVELI III**

Drejtimi mësimor “TIK (pilot - PEM)”

TIRANË, 2015

Programi orientues për provimet përfundimtare të profilit mësimor "**Elektronikë në teknologjinë e automatizimit (pilot-PEM)**", Niveli III përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë profil mësimor, të trajtuara në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e 12-të dhe të 13-të, që i përket këtij niveli.

Ky program i ndihmon nxënësit të përqendrohen në ato kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësuesit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësve.

Për drejtuesit e të gjitha niveleve, këto programe krijojnë mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të nxënësve brenda një institucioni të caktuar shkollor, i cili mund të realizohet duke zhvilluar testime përmbledhëse.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t'i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e nxënësit/es në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në shkollat e larta apo në arsimin pas të mesëm.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimet përfundimtare, është e rëndësishme që herë pas here mësuesit/instruktorët të zhvillojnë testime të nxënësve, me teste praktike, që mund t'i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

Përmbajtja e programit për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në drejtimin mësimor "**Elektronikë në teknologjinë e automatizimit (pilot-PEM)**", Niveli III është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

a) Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, detyrat e punës dhe pikët për secilën kompetencë:

Nr	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1	Të përzgjedhë, përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës.	Në të gjitha detyrat	5
2	Të kryejë matje dhe kontrole në sisteme të kontrollit automatik	Në të gjitha detyrat	10
3	Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit	Në të gjitha detyrat	10
4	Të vizatojë skemat dhe të realizojë	1- Dhënia e detyrës (nga	40

	sisteme të thjeshta të kontrollit automatik	Komisioni) për vizatimin dhe për realizimin e skemës <i>së një</i> sistemi të thjeshtë të kontrollit automatik (duke përdorur edhe programin kompjuterik përkatës).	
5	Të diagnostikojë parregullsitë në sisteme të kontrollit automatik dhe të kryejë zëvendësimin e elementeve të dëmtuara	2- Simulimi (nga Komisioni) i një parregullsie të vështirësisë mesatare <i>në një</i> sistem të kontrollit automatik, diagnostikimi i parregullsisë dhe zëvendësimi i elementeve të dëmtuara	35
		Shuma	100

b) Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve "*me detyra pune*" (në tabelën e parë tregohen 2 detyrat e punës).
- Nxënësit do të vlerësohen për **5 kompetenca bazë**, ku 3 kompetencat e para janë kros-profesionale dhe do të verifikohen nga Komisioni i provimit gjatë kryerjes së veprimtarive në të 2 detyrat e parashikuara.
- Rekomandohet që, gjatë hartimit të listës së kontrollit për përmbushjen e secilës prej detyrave, të parashikohet edhe *bashkëbisedimi profesional* ndërmjet instruktorit dhe nxënësit, në vartësi kjo të peshës/rëndësisë që ka ky element në kompetencën profesionale përkatëse.